



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 29/08

Prishtinë, më 13.11.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Safete Hadërgjonaj, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj, Müfera Şinik, Naser Osmani, Riza Smaka.

Anëtarët jo të pranishëm: Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Myrvete Pantina,

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, Bedri Hamza, zv.ministër i MEF-it, Lulzim Ismajli nga MEF z. Gani Gërguri, zv. Guvernator i BQK-së, Teki Shala nga NDI, monitorues nga, OSCE, NDI, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 28 tetor 2008**
- 3. Shqyrtimi i raportit nr. 03/1248/Do-006 dt. 03.11.2008 nëntëmujor të buxhetit për vitin 2008**
I ftuar: z. Ahmet Shala, Ministër për Ekonomi dhe Financa
- 4. Shqyrtimi i kërkesës 03/1289/Do-785 dt. 11.11.2008 së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për miratimin e Auditorit të Jashtëm të Pasqyrave Financiare për vitin 2008-2010**
I ftuar: z. Gani Gërguri, Zëvendës Guvernator për Operacione Qendrore Bankare
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 28 tetor 2008

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja dt. 28 tetor 2008, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës 03/1289/Do-785 dt. 11.11.2008 së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për miratimin e Auditorit të Jashtëm të Pasqyrave Financiare për vitin 2008-2010 I ftuar: z. Gani Gërguri, Zëvendës Guvernator për Operacione Qendrore Bankare

Kryesuesi, njoftoi se konform ligjit, BQK-ja ka dorëzuar rekomandimin për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm të pasqyrave financiare për vitin 2008-2010. Për më tepër shpjegime i'a dha fjalën përfaqësuesit të BQK-së.

Gani Gërguri, njoftoi se konform ligjit dhe procedurave të Ligjit Prokurimit dhe Ligjit të BQK-së është përzgjedhur kompania KPMG nga Tirana si auditor e jashtme për të bërë auditimin e pasqyrave financiare prej vitit 2008-2010. Komisioni i formuar për këtë qëllim konsideruar se tenderi është valid për shkak të ekzistimit të tre ofertuesve dhe kompanitë konkurruese i kanë përmbushur kushtet ligjore (obligimi për të pasur zyrë në Kosovë). Vendimi i marrë i është dërguar Bordit i cili të njëjtin e ka aprovuar dhe në formë rekomandimi i ka sjellur në këtë Komision ashtu siç e thotë edhe ligji për të marrë vendimin përfundimtar.

Kryesuesi, theksoi se në këtë rast Komisioni duhet të marrë vendim, prandaj duke pasur parasysh faktin se rekomandimi respekton ligjet përkatëse, kërkoi nga anëtarët të votojnë kompaninë e propozuar si auditor të jashtme të pasqyrave financiare të BQK-së për vitin 2008-2010.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për përzgjedhjen e kompanisë KPMG për Auditor të Jashtëm të Pasqyrave Financiare të BQK-së për vitin 2008-2010

4. Shqyrtimi i raportit nr. 03/1248/Do-006 dt. 03.11.2008 nëntëmujor të buxhetit për vitin 2008 I ftuar: z. Ahmet Shala, Ministër për Ekonomi dhe Financa

Kryesuesi, theksoi se shqyrtimi i këtij raporti do të na ndihmonte për të bërë krahasimet në kohën kur do të shqyrtojmë buxhetin. Raporti i përgatitur mirë. Shohim një dinamizëm të realizimit të shpenzimeve në disa segmente, por në disa tjera kemi ngecje, siç është rasti me shpenzimet kapitale. Megjithatë shfaq shpresën se deri në fund të vitit do të arrihet që buxheti i planifikuar të realizohet në masë të konsiderueshme.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, theksoi se nga raporti shifet se ka progres, qoftë në përpilimin e tij por edhe në realizimin e buxhetit. Më pas shpjegoi strukturën e realizimit të buxhetit dhe bëri krahasimet me periudhën paraprake. Janë mbledhur 74,1% e të hyrave të planifikuara (10,3% më e lartë se periudha paraprake e vitit të kaluar). Të hyrat nga tatimet kufitare 73,3% (11% më shumë se vitin e kaluar), ATK-ja ka realizuar 71.8 % të hyra të brendshme (5.3 % më tepër se vitin e kaluar). Trend më i mirë në kthimin e tatimeve (0,67%). Të hyrat jotatimore janë realizuar 88,2 %

(9% më të larta), të hyrat vetanake të nivelit qendror 99,3% (41 % më tepër se vitin e kaluar), komunalet 80% (40.2% më shumë se vitin e kaluar). Sa i përket strukturës së shpenzimeve janë realizuar deri më tani 46.2%. Sipas kategorive, për paga dhe mëditje janë shpenzuar 72 % të planifikuara, për mallra dhe shërbime 48.6% (janë bërë ulje në krahasim me periudhën e kaluar, kjo paraqet një sukses), shpenzimet komunale 56.6%, subvencionet 66% (rritja ka ndikuar nga subvencioni për KEK-un dhe ngritja e pensioneve), shpenzimet kapitale 134,380 € por duke pasur parasysh kohën e ekzekutimit të buxhetit janë në përparësi në krahasim me periudhën e kaluar. Mbi 190 milion € mjete të zotuar dhe kontraktuara për projekte e që do të arrijnë normën prej 90% të atyre të planifikuara.

Haki Shatri, theksoi raporti i përmbush kërkesat ligjore dhe teknike. Te realizimi i të hyrave shifet se kemi një dinamik, por këto do të arrijnë kulmin në tre mujorët e fundit. Megjithatë bëri disa vërejtje. Kërkoi që shpenzimet komunale të paguhen me kohë sepse ato nuk janë kursim, prandaj MEF-i të ndikojë të agjencionet tjera. Çështje tjetër paraqet ngecja në realizimin e shpenzimeve kapitale. Pastaj mosmbyllja e avanceve në shuma të larta (deri 30.000€). Një çështje e rëndësishme që intereso ishte objekti i pallatit të “Rilindjes”, i cili është refuzuar nga Kuvendi ndërsa ai është përfshirë në raport, pyeti si kanë guxuar ta bëjnë atë, kur dihet se ai nuk është futur në rishikimin e buxhetit. Përndryshe theksoi se mbështet raportin.

Riza Smaka, theksoi se është dashur të jepen më tepër sqarime me anë të referencave për termat e përdorura në raport. Bëri vërejtje për mosmbylljen e avanceve, qiraja shumë e lartë për institucionet publike, disa të vendosura edhe në objekte të ndërtuara ilegalisht. Për kategorinë shpenzime të përfaqësimit pyeti se qfarë janë, kush dhe kur përfaqëson. Termi kapital tjetër qfarë nënkupton. Shërbimet kontraktuese shuma të larta, qfarë janë. Do të ishte mirë të bëheshin këto shpjegime në referenca. Përndryshe mbështeti raportin.

Xhevdet Neziraj, theksoi se nga raporti shifet se të hyrat janë në rritje por edhe shpenzimet. Shifet se mobilie dhe pajisje ka më pak se vitin e kaluar por për shpenzime të përfaqësimit dhe dreka kemi 15% rritje. Shqetësuese janë mosrealizimi i shpenzimeve kapitale të cilat po barten si suficit. Kjo shkakton nevojën për ngritjen e kapaciteteve, MEF-i duhet bërë vërejtje në agjencionet tjera për realizimin e buxhetit të tyre brenda vitit. Nga buxheti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, shifet se projektet dhe investimet janë bërë vetëm për komunitetin serb dhe asnjë për komunitetet tjera

Safet Hadërgjonaj, theksoi se raporti është përgatitur mirë teknikisht, i cili ka mundësuar shikimin e detalizuar të rrjedhës së të hyrave dhe shpenzimeve (duke përfshirë edhe shpenzimet në investimet kapitale). U pajtua me opinionet se duhet rritur kapacitetet e agjencioneve buxhetore në planifikimin e buxhetit sepse kjo reflekton në ekzekutimin e buxhetit. Disa shifra nuk janë të kënaqshme, por duke ditur rrjedhën dinamike të të hyrave dhe shpenzimeve në tre muajt e fundit, shfaq shpresën se do të ketë refleksione pozitive në realizimin e mjeteve buxhetore, sidomos në investimet kapitale. Theksoi se i ka bërë përshtypje për të mirë realizimi i buxhetit nga Ministria e Bujqësisë për 53,7%. Theksoi se dinamika e ngadaltë në realizimin e shpenzimeve kapitale nga MEF-i po reflekton jo mirë, që ka ndikuar edhe në uljen e përqindjes së përgjithshme të realizimit të investimeve kapitale (kur dihet se kemi 114% tejkalim të shpenzimeve kapitale në krahasim me periudhën e kaluar). Përndryshe përkrahu raportin.

Hajdin Abazi, theksoi se shifet se kemi avancim dhe përmisim të raportit. Kërkoi disa sqarime. Grantet qeveritare për komunat shifet se janë rritur, pyeti se në qfarë baze janë rritur ato? Është premtuar për uljen e shpenzimeve të Qeverisë për ulje të derivateve dhe telefonatave, por kjo në raport nuk janë pasqyruar, ku qëndron arsyeshmëria. Përndryshe theksoi se përkrahu raportin.

Müfera Şinik, theksoi se është takuar me ekspertë të ekonomisë dhe e kanë sugjeruar se raporti është i përgatitur mirë dhe ka përmisim gjatë këtyre nëntëmuajve dhe shfaqti shpresën se brenda vitit do të realizohet buxheti i planifikuar. Përkrahu raportin.

Bedri Hamza, zv.ministri i MEF-it, njoftoi se deri më 12 nëntor shpenzimet kapitale kanë mbërrijë në realizim rreth 191 milion € Duke i'u përgjigjur pyetjeve për ngecje në shpenzimet kapitale, në muajt që kanë mbetur në bazë të dinamikës së punëve të kontraktuara do të shpenzohen. Për avancet do të kërkohet të mbyllen me kohë. Problemi i qerasë ka të bëjë me faktin e krijimit të institucioneve të reja dhe bartja e përgjegjësisë dhe pamundësia që të gjitha institucionet të vendosen në objekte publike. Për ndërtesën e Rilindjes është bërë zotimi konform ligjeve, paraprakisht ka ndodhur ridestinimin prej një projekti kapital në tjetrin brenda të njëjtës organizatë buxhetore (Ministria e Shërbimeve Publike). Se qfarë janë shpenzimet e përfaqësimit dhe të kontraktimit janë dhënë në fusnota. Në pyetjet për ngritjen e kapaciteteve janë bërë përpjekje që ato të rriten dhe në fakt në disa organizata janë rritur. Ndërsa problemi i mosrealizimit të investimeve kapitale nga MEF-i, ka të bëjë me faktin se fondet që ekzistojnë dhe përdoren vetëm për desitnacione të caktuara, nëse nuk shpenzohen do të barten në vitin e ardhshëm. Grantet për komunat do të ndahen në vitin 2009 në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave lokale. Shpenzimet për derivate janë bërë si rezultat i krijimit të institucioneve të reja dhe bartjes së përgjegjësisë të rezervuara dhe nga ngritja e çmimeve të derivateve të naftës, ndërsa për telefon, në fakt janë bërë kursime (kjo si rezultat i uljes së çmimeve nga operatori).

Naser Osmani, vlerësoi raportin të përgatitur mirë teknikisht. Theksoi se të hyrat do të ishin më të larta sikur të mund të kontrolloheshin dy pikat kufitare doganore në Veri. Duke komentuar planin 6 pikësh të Ban Kim Munit në aspektin ekonomik, theksoi se këto pika do të dilnin jashtë kontrollit të institucioneve vendore. Lidhur me këtë, pyeti se ka shënime apo analiza nga MEF-i se sa do të mund të dëmtohej buxheti si rezultat i mosinkasimit të të hyrave nga këto pika doganore, a do të mund të arrinte buxheti objektivat e planifikuara poqë se nuk arrihet mundësia e mbikëqyerjes në këto pika doganore.

Ahmet Shala, theksoi se shpenzimet kapitale në termat nominal, me të njëjtat kapacitete janë realizuar dyfish më tepër se periudha paraprake dhe me kohë tre muaj më pak, ndërsa për termat relativ ka nevojë për ngritje të kapaciteteve. Rreth pyetjes së z. Osmani theksoi duke i përjashtuar këto dy pika doganore prapë kemi rritje të të hyrave nga doganat. Ndërsa se sa do të humb buxheti nëse nuk ushtrohet kontrolli në vitin e ardhshëm nga këto dy pika, shënimet ekzistojnë por se nuk është gjendje të jap shifra në këto momente.

Kryesuesi, nga diskutimet shifet se raporti mbështet me vërejtjet e bëra, prandaj mund të rekomandohet Komisioni mbështet këtë raport, duke pasur parasysh faktin dhe kohën e diskutimit të Projektbuxhetit për vitin 2009, Kryesia të vlerësoi se a ka nevojë për diskutim në seancën plenare.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, me votimin e bërë Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

I. Miratohet raporti nr. 03/1248/Do-006 dt. 03.11.2008 nëntëmuajor të buxhetit për vitin 2008

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Kryesuesi i Komisionit,

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Gani KOCI